



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJE PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë, 16.10.2017, Palët e mëposhtme:

Këshilli Kombëtar i Territorit, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT
Z. Edi Rama

dhe

Bashkia Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Dritan Leli

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 8, datë 16.10.2017, për objektin: “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstrukcion i objekteve të tjerë ekzistues”, bien dakord si më poshtë:

NENI 1 OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Vlorë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstrukcion i objekteve të tjerë ekzistues”, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 08, datë 16.10.2017.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

qytetit Vlorë, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstrukcion i objekteve të tjerë ekzistues”.

NENI 4

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 4.1 Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

NENI 5

GJUHA E MARRËVESHJES

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

NENI 6

EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

PALËT

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga,
Z. EDI RAMA



BASHKIAVLORE

Përfaqësuar nga,
Z. DRITAN LELI

